



Pranuar / Dorezuar Prilbjenol/Prodato Received/Delivery	29.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	8604/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1074/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, si dhe Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1074/2022 të datës 01.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me Nr.ref.593/2022 të datës 04.11.2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1074/2022 të datës 01.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi _____ përmes përfaqësuesit me autorizim, me datë 01.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7520/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.ref.593/2022 të datës 04.11.2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale dhe procedurave ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli me datë 28.12.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1074/2022 të datës 01.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Ref.593/2022 të datës 04.11.2022 të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Kërkesën për qasje në dokumente publike të dërguar nga V.H të datës 14.11.2022; E-mail i dërguar nga V.H për M.I, V.B dhe A.K të datës 25.11.2022; Autorizimin e ankuesit të datës 21.11.2022; Vendimin për emërim dhe caktim të gradës diplomatike me numër Ref.293/14 të datës 30.04.2014; Vendimin me numër Ref.033/16 të datës 02.02.2016; Vendimin me numër Ref.682/2018 të datës 24.07.2018; Vendimin me numër Ref.106/2020 të datës 27.03.2020; Vendimin me numër 198/2020 të datës 13.05.2020; Vendimin me numër 259/2020 të datës 30.06.2020; Vendimin për sistemim të Përkohshëm ; Vendimin me numër Ref.372/2021 të datës 28.03.2021; Vendimin me numër 452/2022 të protokolluar me numër 2635 të datës 13.07.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të dërguara nga KSHMPCK për MPJD të protokolluar me numër 8138 të datës 15.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 8504/2022 të datës 28.12.2022; Vendimin me numër 564/2018 të datës 13.07.2018; Vendimin me numër 311/2020 të datës 10.07.2020; Vendimin me numër 135/2020 të datës 01.09.2020;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të shkresave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil *nuk është kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1074/2022 të datës 01.12.2022 të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga analizimi i provave materiale Kolegji ka gjetur së Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme me Vendimin të datës 22.07.2011 ka miratuar shpalljen e Konkursit për përfaqësues diplomatik dhe konsullor në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë vendim, Ministria e Punëve të Jashtme më datë 22.07.2011 shpall Konkursin për drejtues dhe nëpunës të tjerë të misionit konsullor dhe për anëtarë të misionit diplomatik, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi. Me tej, nga shkresat e lëndës rezultojnë së lidhur me këtë procedurë konkurrimi ishte organizuar vetëm testimi i gjuhëve të huaja dhe intervista me gojë, dhe nga kjo fazë nuk ka dëshmi për vazhdimin e mëtejshëm të procesit të rekrutimit në fjalë, gjegjësisht pranimit të ankuesit në pajtim me dispozitat e aplikueshme për shërbimin e jashtëm dhe shërbim civil.

Rrjedhimisht nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar së ankuesi bazuar në Vendimin Nr.Ref 293/12 të datës 30.04.2014 të Ministrit të Punëve të Jashtme emërohet anëtarë i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke i'u caktuar grada diplomatike "Sekretar i dytë", dhe njëkohësisht i njëjti caktohet të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Arabisë Saudite nga data 01.06.2014. Tutje bazuar në provat e lëndës rezultojnë së ankuesi me Vendimin me numër 033/16 të datës 02.02.2016 të Zëvendëskryeministrit të parë dhe njëkohësisht Ministër i Punëve të Jashtme e autorizon për kryerjen e shërbimeve konsullore. Tutje me vendimin me numër Ref.682/2018 të datës 24.07.2018 ankuesi Vahid Haxhiu ngritet në detyrë nga pozita "Sekretar i dytë" në pozitën "Sekretar i parë". Ndërsa me vendimin me numër Ref.106/2020 të datës 13.05.2020 "Sekretar i parë" pas përfundimit të mandatit e tërheq/kthen nga misioni diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Tutje përmes vendimit me nr.Ref 198/2020 të datës 13.05.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak të pandemisë shtyn ekzekutimin e një mori vendimesh për tërheqjen e diplomatëve nga misionet diplomatike, ku ndër ta edhe kthimin e ankuesit. Ndërsa me vendimin me numër Ref.259/2020 të datës 30.06.2020 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të pezulluara, shtyen ekzekutimin e një mori vendimesh deri në nxjerrjen e vendimeve të veçanta për secilën ndarazi ku ndër ta edhe vendimin për.



Tutje me Vendimin numër 139/2020 të datës 01.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ankuesi Vahid Haxhiu sistemohet me kohëzgjatje të përkohshme në pozitën Zyrtar i Lartë për Politika Konsullore në Departamentin për Çështje Konsullore. Në vazhdimësi Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës nxjerr Vendimin me numër Ref.372/2021 të datës 28.09.2021 me të cilin me gradë "Sekretar i parë", caktohet të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe me mandat 4 vjeçar. Tutje me Vendimin me numër Ref.452/2022 të datës 13.07.2022 transferohet përkohësisht në detyrë kujdestarie deri në kthimin e shefit të misionit nga pushimi vjetor në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Riad të Arabisë Saudite.

Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me Vendimin Nr.ref: 593/2022 të datës 03.11.2022 ka shfuqizuar Vendimin me numër reference 293/14 të datës 30.04.2014 lidhur me emërimin e ankuesit në shërbim të jashtëm si dhe vendimin me numër Ref.372/2021 të datës 28.09.2021, mbi bazën ligjore së emërimi i ankuesit në shërbim të jashtëm është bërë në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm.

Ankuesi në ankesën me numër A.nr.1074/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon së vendimi i kundërshtuar më ankesë karakterizohet me shkeljeve të dispozitave ligjore dhe procedurale duke i propozuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që ta aprovoj ankesën e ankuesit dhe ta anuloj vendimin e datës 04.11.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm në kohën e emërimit të ankueses në shërbim të jashtëm, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik me të cilin parashihet: Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se përveç të emëruarave politikë, nëpunësit e shërbimit të jashtëm përfshirë personelin diplomatik, konsullor dhe personelin administrativ të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo të angazhuar në shërbim të jashtëm, kanë statusin e nëpunësit civilë dhe së pranimi i tyre në shërbim të jashtëm duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbim të jashtëm dhe legjislacionit të aplikueshëm për shërbim civil, andaj mbi këtë bazë ligjore, si dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesi ishte emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimit të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e meqenëse me asnjë provë nuk vërtetohet se i njëjti ka themeluar marrëdhënie të punës në shërbim civil përmes nënshkrimit të Aktit të emërimit ashtu siç përcaktohej me nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin parashihej se: *Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkresë të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil....*, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në*

Shërbimin Civil, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit si në dispozitiv të këtij vendimi.


Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të provave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1074/2022

Çlirim Zeka


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit
- Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporë ; dhe
- Arkivoit të KPMSHCK-së

